



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS



V E N D I M

Nr. 27, datë 02.06. 2016

“Mbi vlerësimin e dëmeve nga ana ndërtimore të familjes së Z.Ded Luk Kola, banor i Lagjes Park, Bashkia Vau Dejës”

Bashkia Vau i Dejës pas shqyrtimit të dokumentacionit të rikthyer nga Ministria e Punëve të Brendshme, konkretisht procesverbalit date 25.01.2012 “Per konstatim të dëmeve të shkaktuara në banesën e djegur” të Komisionit të Verifikimit të Dëmeve (bashkëngjitur), Preventivit për “Vlerësimi i dëmeve nga ana ndërtimore”, miratuar nga Këshilli i Qarkut Shkoder (bashkëngjitur).

Bazueshmeria ligjore: ligjit Nr.139/2015, “Per vetqeverisjen vendore”; Ligjin nr.8756 datë 26.03.2001 “Për emergjenat civile” i ndryshuar; Vendimit të Keshillit të Ministrave nr.329, date 16.05.2012 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore”, Udhezimi i perbashket Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Financave nr.263 date 24.05.2013 “Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare, per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njezore”; Udhezimit nr.4 date 23.11.2011 të KM “Per miratimin e koston mesatare te ndertimit te banesave nga Enti Kombetar i Banesave per vitin 2011”, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës pas shqyrtimit të projekt-vendimit të paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile, Bashkia Vau i Dejes për të përballuar dëmet e shkaktuara nga djegia e shtëpisë e ndodhur me datë 18/01/2012 në familjen e z.Ded Luk Kola ne Lagjen Park, Bashkia Vau i Dejes të përbërë me 2 anëtarë, në mbledhjen e datës 02/06/2016, më shumicë të cilësuar votash :

VENDOSI:

1. Vlera e dëmit nga ana ndërtimore është në shumën 1,182,276 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) leke sipas preventivit të hartuar nga ing Sami Gruemira, dhe të miratuara nga Këshilli i Qarkut Shkoder dhe Bashkia Vau Dejës. Vlera e dëmit është përlllogaritur sipas legjislacionit në fuqi në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore.
2. Ti popozojë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhënien e diferencës midis ndihmës financiare të dhënë nga Këshilli i Bashkisë Vau i Dejes me vendimin nr.26, datë 23.05.2012 në vlerën 10,000 dhjetë mijë lekë (bashkëngjitur) dhe dëmeve të konstatuara nga ana ndërtimore dhe dëmeve në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Financës.

5. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga Buxheti i vitit 2016.

5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

6. U shpall sot me date 10 / 06 / 2016.

SEKRETARI
Gentian NDOJ



KRYETARI
Martin MARKU

